

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.M. për veprën penale Ushtrimi i ndikimit në bashkëkryerje, nga neni 345 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprës penale Ushtrimi i ndikimit në bashkëkryerje nga neni 431 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S.M., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj PKR.nr.155/2016 datë 25.01.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 21.03.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj PKR.nr.155/2016 datë 25.01.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj me aktgjykimin PKR.nr.155/2016 datë 25.01.2017, e ka shpallur fajtor të akuzuarin S.M. për veprat penale Ushtrimi i ndikimit në bashkëkryerje, nga neni 345 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprës penale Ushtrimi i ndikimit në bashkëkryerje nga neni 431 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, për çka i ka përcaktuar për veprën penale nën pikën 14 dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve ndërsa për veprën penale nën pikën 16 dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, ashtu që konform nenit 80 par.1 të KPRK i ka shqiptuar dënim unik në kohëzgjatje prej 3 vite e 2 muaj në të cilin dënim ia ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga 11.09.2013 dhe është vendosur në paraburgim me 12. Shtator 2013. E ka urdhëruar që të paguaj familjes S. dëmshpërblimin për humbjen e 25.000 mijë eurove të zhvatura së bashku me të bashkë akuzuarin B.V., në të kundërtën prokurori mund të ri hyj në çështje pran trupit gjykues apo ndonjë anëtarë të tij për të konsideruar ndonjë dënim alternativ. Është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 100 eurove në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit S.M. av. A.A., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të dispozitave të

Kodit Penal të Kosovës, vendimit lidhur me sanksionin penal dhe vendimit – kërkesës për pagimin e dëmshpërblimit, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket dënimit dhe të akuzuarit të i shqiptohet një dënim më i butë si dhe të akuzuarin ta liroj nga detyrimi për pagesën e dëmshpërblimit apo ta anulon në këtë pjesë aktgjykimin dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

-Përgjigje në ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Ferizaj, me propozim që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.M. të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit në të cilën morën pjesë i akuzuari S.M. dhe mbrojtësi i tij av. A.A. ndërsa nuk mori pjesë Prokurori i Apelit edhe pse i ftuar me rregull. Mbrojtësi av. A.A. mbeti pranë ankesës së tij ndërsa i akuzuari S.M. i përkrahi fjalët e mbrojtësit të tij.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I nr.106/17, të dt. 06.03.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit av. A.A. të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj qeshjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.M. av. A.A. është e pa bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.M. av. A.A. aktgjykimin e shkallës së parë e atakon për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale duke pretenduar se gjykata ka urdhëruar dëmshpërblimin në shumë prej 25.000 euro të zhvatura nga të akuzuarit, edhe pse pala e dëmtuar në shqyrtim gjyqësor nuk ka marr pjesë dhe as nuk ka paraqitur kërkesë pasuroro-juridike. Këtë e ka bërë duke shkel dispozitat e Kodit të Procedurës Penale-nenin 458 par.1 të KPP e që kjo shkelje është bërë në dëm të akuzuarit. Po ashtu kemi shkelje të nenit 459 par.1 të KPP meqenëse nuk kemi një propozim për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike nga pala e autorizuar, e po ashtu një propozim i tillë mungon edhe nga pala e autorizuar deri në shqyrtimin kryesor e që është në kundërshtim me nenin 460 par.2 të KPP. I akuzuari S.M. nuk është i akuzuar për zhvatjen e 25.000 eurove me datë 27.nëntor 2012 në pikat 14 dhe 16 të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Kjo gjykatë shqyrtoi ankesën dhe aktgjykimin e shkallës së parë dhe vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit S.M. lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale janë të pa bazuara. Aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsyet për faktet vendimtare si dhe arsyetimin lidhur me detyrimin e të akuzuarit S.M. që palës së dëmtuar – familjes Sylejmani t'ia kompensoj dëmshpërblimin për parat e zhvatura në shumë prej 25.000 euro. Kjo për faktin se nuk qëndron pretendimi i

mbrojtjes se mungon propozimi për kërkesë pasuroro-juridike në çështjen konkrete pasi që nga shkresat e lëndës shihet se përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. B.S.2. me shkrim ka propozuar që të aprovohet kërkesa pasuroro-

juridike në fjalën përfundimtare, ku përveç kërkesës që të kompensohet shuma prej 25.000 eurove ka kërkuar edhe shumë tjetër sa i përket edhe dëmit jo material të shkaktuar të dëmtuarit. Po ashtu nga aktgjykimi i shkallës së parë vërehet se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për dy vepra penale të ushtrimit të ndikimit gjegjësisht se kanë kërkuar dhe kanë marrë pagesë monetare në shumë prej 25.000 euro për të e konsideruar ushtrimin e një ndikimi të pa përshtatshëm nga ana e kryesve të veprës penale mbi vendimmarrjen e personit zyrtar për ta liruar B.S. apo që ai të mos dënohet dhe të vuaj dënimin. Prandaj duke pas parasysh pranimin e fajësisë të akuzuarit dhe propozimin e palës së dëmtuar që ka arsyetuar të njëjtën, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarin S.M. e ka obliguar që së bashku me të akuzuarin tjetër B.V. të paguajnë shumën prej 25.000 euro në emër të zhatjes nga familja S.i, e konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjendja faktike nuk u kontestua meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit, nuk janë të bazuara. Mbrojtësi në këtë rast nuk ka cekur ndonjë rrethanë të re e që kishte me ndikuar në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit, por thekson se dënimi është tejet i rëndë dhe se nuk janë vlerësuar rrethanat lehtësuese se i akuzuari ka pranuar veprat penale, se për veprën nën pikën 14 dënimi është i paraparë me gjobë apo me dënim me burgim deri në 2 vite ndërsa gjykata i ka shqiptua dënimin maksimal 2 vite përkundër faktit se ai ka pranuar këtë vepër penale, kurse për veprën penale nën pikën 16 i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 viteve e që dënimi për këtë vepër parashihet me gjobë apo me dënim me burgim deri në 8 vite e që dënimin unik të shqiptuar nga gjykata është 3 vite e 2 muaj, është penduar thellësisht, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të kësaj natyre, se është mbajtës i vetëm i dy prindërve të shtyrë në moshë dhe nuk ka kush të kujdeset dhe me një dënim më të butë apo me kohën e qëndrimit në paraburgim do të arrihet qëllimi i dënimit. Pra gjykata në veprën e parë penale nuk ka aplikuar dispozitën e nenit 73-76 të KPRK në të cilën jo vetëm që parashihet që gjykata të vendos nën minimumin ligjor për më tepër jep mundësi të përcaktoj dënimin edhe nën minimumin e paraparë sidomos në rastin kur i akuzuari e pranon fajësinë. Andaj Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të ankesës së mbrojtësit në këtë drejtim vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese siç është pranimi i fajësisë, se është njeri familjar, më parë i pa gjykuar dhe se ky dënim është i justifikueshëm në raport me rrethanat e kryerjes së veprave penale, rrezikshmërisë së saj dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.98/2017, më 21.03.2017

Eroll Gashi

1. Mejreme

Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____